



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVA

QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA /GOVERNMENT OF KOSOVA

MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME / MINISTARSTVO UNUTRAŠNJIH POSLOVA/  
MINISTRY OF INTERNAL AFFAIRS

# RAPORT PUNE

(për gjashtë (6) mujorin)

*Abduselami Shkodra,*

*Zëvendës Ministër në Ministrinë e Punëve të Brendshme*

*Prishtinë, 12.05.2018*

## HYRJE

Bazuar në mandatin e dhënë si Zëvendës Ministër i Ministrisë së Punëve të Brendshme, kam filluar me angazhimin në implementimin e planit të Qeverisë dhe në zbatim të detyrave dhe kompetencave ligjore. Me vendimet e Ministrit të MPB-së, numër 319/2017 dt. 01.11.2017 emërohem koordinator nacional kundër narkotikëve, me vendimin 321/2017, dt. 01.11.2017 emërohem koordinator kombëtar për sigurinë kibernetike, si dhe me vendimin numër 327/2017. Dt. 01.11.2017 emërohem koordinator nacional kundër krimit të organizuar. Me qëllim të përmbushjes së mandatit dhe detyrave kam zhvilluar aktivitete që kanë reflektuar me zbatimin e objektivave si dhe intensifikimin e aktiviteteve në zbatim të ligjit. Gjatë kësaj periudhë kam realizuar

- 15 vizita pune,
- 19 takime pune,
- 9 pjesëmarrje dhe organizimi i/ne konferenca ndërkombëtare si dhe
- 4 vizita pune jashtë vendit.

Gjithashtu, kam udhëhequr procesin e hartimit të strategjive nacionale, kam participuar në konferenca ndërkombëtare në të cilat është trajtuar dhe diskutuar lufta kundër drogave si dhe nevoja e themelimit të mekanizmit të observatorit (Bruksel). Po ashtu, e rëndësishme ka qenë marrja e përvojave për siguri kibernetike (Zvicër). Si dhe vizita të ndryshme punë me qëllim të mbikëqyrjes së implementimit të objektivave strategjike si dhe zbatimin e legjislacionit në fushën e projektit "*Stop Drogave në Shkolla*".

## PREZANTIM I TË ARRITURAVE

### Krimi i organizuar

Në cilësinë e Koordinatori Kombëtar kundër krimit të organizuar, narkotikëve dhe krimit kibernetikë kemi ngritur në prioritetet më të larta përpjekjet institucionale dhe strategjike në këtë luftë. Kam organizuar katër takime pune<sup>1</sup> të këshillit kombëtar për zbatimin e strategjisë, në të cilin janë prezantuar zbatimi i objektivave si dhe të arriturat në luftën kundër krimit të organizuar.

Lufta kundër krimit të organizuar ka shënuar sukses, si në aspektin e reformës së nevojshme legislative, hartimit të politikave, ashtu edhe në implementimin e legjislacionit dhe përmbushjen e objektivave strategjike. Duke pasur parasysh që Kosova tashmë ka përmbyllur me sukses fazën e konsolidimit të mekanizmave, kemi vendosur avancimin e politikave në strategjinë e re 2018-2022, duke u dhënë prioritet objektivave strategjike në *parandalimin dhe luftimin e formave të krimit të organizuar*, fuqizimin e mëtejshëm të kapaciteteve në parandalimin dhe luftimin e krimit të organizuar, si dhe zhvillimin e bashkëpunimit dhe koordinimit në mes akterëve vendor dhe ndërkombëtar në **parandalimin dhe luftimin e krimit të organizuar**. Lufta kundër krimit të organizuar është fuqizuar duke ashpërsuar masat dhe rritjen e numrit të rasteve të hetuara. Në vitin 2017 janë hetuar 161 raste të veprave penale kundër ekonomisë, janë hetuar 166 raste të veprave penale kundër detyrës zyrtare, janë hetuar 111 raste kundër pasurisë. Në fushën e Luftimi të Krimit Ekonomik dhe Korrupsionit gjithashtu janë organizuar 9 operacione policore dhe 28 plane operative, janë arrestuar 91 persona të dyshuar, janë ngritur 370 kallëzime penale dhe janë shkatërruar 7 grupe të organizuara kriminale, si dhe janë hetuar 3 raste kontrabandë me mallra, 3 raste të trafikimit të armëve, 3 raste të skemave piramidale, 6 raste të auto krimeve dhe 54 raste të krimeve kibernetike.

---

<sup>1</sup> Dhjetor 2017, Janar 2018,

## Lufta kundër Narkotikëve

Lufta kundër narkotikëve është ndër prioritet kryesore e punës time. Në këtë aspekt është vazhduar duke hartuar strategjia e re kundër narkotikëve 2018-2022, e cila parasheh ngritjen e efikasitetit të luftës kundër narkotikëve. **Veprimet e parapara janë te orientuara dhe ndërlidhura për te reduktuar kërkesën e dhe ofertës me qellim te minimizimit te dëmeve nga dukuria e narkotikeve.** Duhet theksuar se ndër veprimet e para që ka ndërmarrë kjo qeveri në vitin 2017 ka qenë kërkesa për *hartimin e planeve* për luftimin e shitjes dhe përdorimit të drogave në shkolla, veprim ky i cili ka dhënë rezultatet të prekshme ku janë bërë 6461 patrullime e 205 arrestime, si dhe fushata vetëdijësuese nëpër shkolla.

Në vitin 2017 është rritur për 63% numri i arrestimeve të trafikantëve në 1426 të arrestuar, si dhe janë konfiskuar mbi 1908 kg mariuhanë e 711 kg heroinë. Tani jemi ne fazën e funksionalizimit të observatorit te drogave si mekanizëm i rëndësishëm ne grumbullimin me të dhëna ne kohe reale nga te gjithë mekanizmat institucional dhe ne orientimin e politikave ne luftën kundër drogave.

## Krimet Kibernetike

Në kuadër të luftës kundër krimeve kibernetike kam udhëhequr procesin e hartimit të koncept dokumenti si bazë orientuese e politikave dhe mekanizmave kundër krimit kibernetike. Në koncept dokument parashihet reforma e nevojshme legjislativ (duke inkorporuar direktivën e re, si instrument për te trajtuar kërcënimet si: sulmet ne shkalle te gjere kundër sistemeve te informacionit, ngritjen e dënimeve ne rastet e nxitjes, ndihmës, mbështetjes dhe përpjekjes për kryerjen e krimeve kibernetikë) si dhe ngritja e kapaciteteve njerëzore dhe teknologjike.

Gjithashtu, Kosova ka arritur të përcjell trendin e zhvillimeve në këtë fushë. Në vitin 2017 është ngritur numri i rasteve të krimeve kibernetike dhe asistimeve të nevojshme në 199 raste.

MPB, do te vazhdoj ne luftimin e pakursyer ne parandalimin, zvogëlimin deri ne çrrënjosje te dukurive negative qe prekun jetën e qytetarit te Republikës se Kosovës. Në vazhdimësinë e

aktiviteteve koordinuese kam mbajtur tri takime pune me këshillin kombëtar për mbikëqyrjen e zbatimit të strategjisë<sup>2</sup>.

### HARTIMI I DOKUMENTEVE STRATEGJIKE

Në kuadër të luftës kundër krimit të organizuar, kundër drogave, dhe kundër krimeve kibernetike, me prioritet janë zhvilluar politikat në këtë drejtim përmes hartimit të dokumenteve strategjike, si bazë për të ngritur efektivitetin dhe efikasitetin e këtyre politikave. Kam udhëhequr proceset e hartimit dhe finalizimit të strategjive nacionale, siç janë:

- koncept dokumenti për parandalimin dhe luftimin e krimit kibernetikë,
- strategjia kundër narkotikëve dhe plani i veprimit 2018-2022,
- strategjia shtetërore dhe plani i veprimit kundër krimit të organizuar 2018-2022.

### TAKIME PUNE

06.10.2017 takim pune me delegacionin e Britanisë së Madhe, të udhëhequr z. Richard Riley si dhe ambasadori Ruairi O'Connell, Prishtinë

12.10.2017 takim pune me përfaqësuesit e sindikatës së policisë, me teme; sigurimet shëndetësore dhe kushtet e punës në Polici', Prishtinë.

21.11.2017 Takim pune i këshillit kombëtar kundër krimit të organizuar, Prishtinë

23.11.2017 Takim pune i këshillit kombëtar kundër narkotikëve, Prishtinë

24.11.2017 Takim pune me Ministrin e drejtësisë së Hungarisë, Prishtinë

06.12.2017 Takim pune me znj, Ana Vlahovich, zyrtare nga ambasada amerikane në Prishtinë, përgjegjëse për siguri kibernetike dhe ekstremizmin e dhunshëm, Prishtinë.

11.12.2017 Organizmi i punëtorisë për vlerësimin e planit të veprimit të strategjisë së sigurisë kibernetike, Pejë

---

<sup>2</sup> 02.05.2018 Prishtinë,

14.12.2017 takim pune me z.Pedro Serrano, zv. Sekretari i Përgjithshëm për politikat e përbashkëta të sigurisë, mbrojtjes dhe reagimit ndaj krizave, Prishtinë

20.12.2017 Takim pune ne këshillin nacional për siguri kibernetike, Prishtine

29.01.2018 takim pune me përfaqësuesit të shoqatave të sigurisë në Kosovë, me temë ulja e numrit të automjeteve të paregjistruara në Kosovë

29.01.2018 takim pune me përfaqësuesit e komunës së Prishtinës për çështjen e ndërmarrjes së masave për përmirësimin e cilësisë së ajrit në kryeqytet

30.01.2018 takim pune me këshillin kombëtar në luftën kundër narkotikëve

02.02.2018 takim pune me Kongresistin Amerikan z. Steven Palazzo

13.02.2018 Takim pune me përfaqësuesit e lartë të qendrës Evropiane për monitorimin e Drogave dhe substancave narkotike (EMCDDA)

16.02.2018 Pjesëmarrja në ushtrimin “Reagimi i përbashkët 2018”, i organizuar nga AME, Ambasada e SHBA, Garda e IOWAs, dhe Agjencia federale e menaxhimit të emergjencave të SHBA, Vushtrri

26.02.2018 Takim i këshillit kombëtar kundër krimit të organizuar

01.03.2018 Takim pune më Kryetarin e ARKEP-it, Prishtinë

13.03.2018 Takim pune me drejtorinë e policisë së Shqipërisë, z. Ardi Veliu, Prishtinë

21.03.2018 Takim pune me Znj. Erin Sawyer, Drejtoresha e Zyrës për Evropë dhe Azi pranë Byrosë për çështjen ndërkombëtare të narkotikëve dhe zbatimit të ligjit të Departamentit të shtetit, Prishtinë

27.03.2018 Takim pune me bordin e projektit të Kosovës për siguri, Prishtinë

27.04.2018 Vizitë pune në pikë kalimin kufitar në Mendarë, me qëllim të mbikëqyrjes së mbarëvajtjes së punës dhe detyrave, si dhe përgatitjet për lëshim në funksion të pikës së përbashkët kufitare në kuadër të MIK

04. 05.2018 Takim pune me z. Simon Mordye, Zëvendës drejtor i drejtorisë së përgjithshme të Komisionit Evropian për migrim dhe punë të brendshme, në kuadër të misionit vlerësues

përfundimtar për zbatimin e kritereve të udhërrëfyesit për liberalizim të vizave (raportim),  
Prishtinë

## VIZITA PUNE

18.12.2017 Vizitë pune në drejtorinë rajonale Prishtinë, Ferizaj, Gjilan në kuadër të projektit “stop drogave nëpër shkolla”, me qëllim të mbikëqyrjes së të arriturave të projektit

20.12.2017 Vizitë punë në OJQ Labirinth, me qëllim të intensifikimit e bashkëpunimit për aplikimin e masave alternative kundrejt masave të dhunshme për përdoruesit e drogave, Prishtinë

22.12.2017 Vizitë pune në MASHT me qëllim të bashkërendimit të përpjekjeve në kuadër të implementimit të strategjisë kundër narkotikëve, dhe planit “stop drogave nëpër shkolla”, Prishtinë

28.12.2018 Vizitë pune në komunën e Junikut me qëllim të përrurimit të qendrës së regjistrimit civil, Junik

15.01.2018 Vizitë pune klinikës së psikiatrisë në kuadër të implantimit të strategjisë kundër narkotikëve, Prishtinë

16.01.2018 Vizitë pune në aeroportin ndërkombëtar të Prishtinës në kuadër të implementimit të strategjisë kundër narkotikëve

07.02.2018 Vizitë punë kryetarit të komunës së Gjakovës, z. Ardian Gjini

07.02.2018 Vizitë punë drejtorisë rajonale të policisë së Gjakovës, si dhe inspektimi i ndërtimit të objektit të policisë rajonale në Gjakovë

15.02.2018 Vizitë pune në Akademinë për siguri në Vushtrri, me qëllim njoftimit nga afër për punën e akademisë si dhe planin e trajnimeve të AKSP për vitin 2018

16.02.2018 Vizitë pikës kufitare në Hani i Elezit

16.02.2018 Vizitë pune kryetarit të Hanit të Elezit, z. Refki Suma

07.03.2018 Agjencioni i Kosovës për Forenzikë

20.03.2018 Vizitë pune në komunën e Prishtinës, Prishtinë

30.04.2017 Vizitë pune në Hanin e Elezit për të ofruar mbështetjen institucionale të MPB në kërkim shpëtim të dy policeve të aksidentuar në magjistralen Prishtinë Shkup, Hani i Elezit

05.05.2018 Prezantimi dhe lëshimi në funksion i E-Kioska të vendosur të objektin e Agjencinë e Regjistrimit Civil në MPB, Prishtinë

### **PJESËMARRJES NE KONFERCA**

26.10.2017 Penalistë në konferencën ndërkombëtare te organizuar nga UNDP dhe ambasada italiane e Kosovës, me teme' radikalizmi dhe ekstremizmi i dhunshëm, Prishtinë.

02.12.2017 Organizimi dhe prezantimi ne konferencën ndërkombëtare me teme "luftimi i krimit të organizuar dhe korrupsionit nga institucionet e republikës së Kosovës" Prishtine

12.01.2018 Konferenca e organizuar nga oda ekonomike Amerikane me temë "Siguria Kibernetike në Kosovë" në cilësinë e panelistit

25.01.2018 konferenca ndërkombëtare me temën "Cyber security and privacy" në cilësinë e panelistit

31.01.2018 konferenca me temë "Avancimi i të drejtave të njeriut në polici" në cilësinë e panelistit

01.02.2018 konferenca me temë “E ardhmja e nënshtetësisë dhe liria e lëvizjes së pjesëtarëve të komunitetit jo shumicë në Kosovë” në cilësinë e panelistit

02.02.2018 konferenca me temë “Ekstremizmi dhe radikalizmi i dhunshëm - edukimi çelës për tu përballur me ekstremizmin dhe radikalizmin online” në cilësinë e panelistit

08.02.2018 Konferenca me temë “Kosova në 10 vjetorin e pavarësisë - të arriturat e sfidat”, në cilësi të panelistit.

20.02.2018 Konferenca me temë “1 dekadë shtet - sfidat e sigurisë në Kosovë”, në cilësi të panelistit.

### **VIZITA PUNE JASHTË VENDIT**

16.03.2018, Vizitë punë për ‘sigurinë kibernetike dhe trendët e reja në luftën kundër kësaj dukurie’, Zvicër

20.03.2018 Vizitë punë në Republikën e Maqedonisë, takim me krye parlamentarën e Maqedonisë, z. Talal Xhaferi, takim pune në Ministrinë punëve të brendshme, respektivisht Zëvendës Ministrinë e punëve të brendshme z. Agim Nuhiu

13.04.2018 Pjesëmarrja në takimin e ministrave të brendshëm të Ballkanit perëndimor, Sofje.

18.04.2018 Pjesëmarrja dhe prezantimi në konferencën e organizuar komisioni Evropian me shtetet anëtare dhe vendet perëndimore me temë “Dialogu i eksperteve në mes Bashkimit Evropian dhe Ballkanit Perëndimor”, Bruksel

*Sinqerisht,*

*Abduselami Shkodra,*

*Zv. Ministër në Ministrinë e Punëve të Brendshme*

*Qeveria e Republikës së Kosovës*

*Koordinator Nacional kundër Krimit të Organizuar,*

*Koordinator Nacional kundër Narkotikëve, dhe*

*Koordinator Nacional kundër krimit Kibernetikë.*